

## RELACION

### PËR

### PROJEKTLIGJIN

#### “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 80/2020, “PËR POLICINË E BURGJEVE””

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2020, “Për Policinë e Burgjeve”” ka si qëllim përmirësimin e Policisë së Burgjeve dhe adresimin e **problematikave** të dala nga zbatimi i ligjit nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”. Ligji nr. 80/2020 gjatë zbatimit në praktikë ka sjellë problematika lidhur me pranimin në Policinë e Burgjeve, pezullimin, rikthimin apo përparësinë në pranim. Problematika të cilat kanë sjellë si pasojë mungesa në strukturën e Policisë së Burgjeve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Nisma ligjore ka si qëllim shmangien e mëtejshme të **vakancave** në strukturën e Policisë së Burgjeve. Rrjedhimisht dhe shmangien e situatave ku mund të cenohet rendi dhe siguria në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji konsistojnë në:

krijimin e një stafi me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar **sigurinë** në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;

përmirësimin e **kritereve** për pranimin në Policinë e Burgjeve;

rishikimin e **kritereve** për ecurinë në karrierë të punonjësve të Policisë së Burgjeve;

parashikimin e **kritereve** të detajuara në lidhje me rikthimin dhe përparësinë për pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve;

rishikimin e **rasteve** të pezullimit nga detyra të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve të planifikuara për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2022 miratuar me vendimin nr. 850, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022”.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, pjesë e paketës penitenciare, reformoi në tërësi Policinë e Burgjeve duke përcaktuar rregulla të qartë mbi organizimin dhe funksionimin e Policisë së Burgjeve, të drejtat dhe detyrat e punonjësit të Policisë së Burgjeve, si dhe marrëdhëniet e punës dhe statusin e punonjësve të këtij shërbimi. Punonjësi i Policisë së Burgjeve gëzon status të veçantë sipas këtij ligji.

Pavarësisht se kanë kaluar më pak se dy vite nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 80/2020, në praktikë janë shfaqur disa problematika, kryesisht sa i takon rekrutimit të punonjësve, të cilat duhet të adresohen. Drejtoria e Policisë së Burgjeve e ushtron veprimtarinë në nivel qendror dhe në 22 institucione të ekzekutimeve të vendimeve penale (IEVP). Për shkak të shumë problematikave të parashtruara rezulton se në 3 proceset e fundit të rekrutimit të punonjësit të rolit bazë në Policinë e Burgjeve numri i pjesëmarrësve ka qenë disa herë më i ulët se numri i vendeve të lira që kishte shpallur DPB, duke sjellë si pasojë zhvlerësimin e procesit të konkurrimit. Gjithashtu, është konstatuar se shumë konkurrentë janë skualifikuar nga e drejta për konkurrim për shkak të kriterit të përcaktuar në nenin 29, shkronja “ë” e ligjit nr. 80/2020, konkretisht kriteri i moshës nën 35 vjeç.

Referuar problematikave të pasqyruara, sot në strukturën e Policisë së Burgjeve janë rreth 400 vende vakante ku disa institucione si IEVP Fier, Peqin apo Reç kanë përrreth 70-80 mungesa secili. Vakancat shoqëruar dhe me lejet vjetore apo mungesat në punë për shkak të mungesës së aftësisë së përkohshme ka sjell si pasojë që një pjesë e IEVP-ve të kryejnë detyrat në fushën e sigurisë me 25 – 30 % mungesa në staf duke hasur në vështirësi serioze në ruajtjen e rendit dhe sigurisë, ulje të cilësisë së shërbimit, rënie të vigjilencës etj.

Me qëllim adresimin e këtyre problematikave, projektligji ofron një kornizë të plotë lidhur me kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve, të drejtën për të mbajtur armë, ecurinë në karrierë, pezullimin nga detyra dhe rikthimin apo përparësinë për pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, Ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji. Ndaj edhe nisma e propozuar, paraqitet si një iniciativë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim të legjislacionit me acquis të Bashkimit Evropian, ndaj nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligj ka në përmbajtje të tij 6 nene me përmbajtje si vijon:

Neni 1 parashikon ndryshime në nenin 14, të ligjit nr. 80/2020. Konkretisht, propozohet ndryshimi i pikës 1 duke parashikuar të drejtën e punonjësit të Policisë së Burgjeve të mbajë armë dhe pajisje të tjera kufizuese. Llojet e armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Burgjeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Mbajtja e armës është një domosdoshmëri për shkak të natyrës së punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve. Aktualisht, punonjësit e strukturës së posaçme në Policinë e Burgjeve, grupet e shoqërimit, përgjegjësit e shërbimit në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe forcat operationale e mbajnë armën në përdorim personal edhe jashtë orëve të shërbimit. Parashikim i cili parashikohet të shfuqizohet nëpërmjet këtij projektligji.

Neni 2 parashikon ndryshime në nenin 29, të ligjit nr. 80/2020 sa i takon kriterëve për pranimin në Policinë e Burgjeve. Konkretisht, në pikën 1 parashikohet ndryshimi i shkronjës “d”, të pikës 1 duke përcaktuar si kriter faktin që personi të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

- i. për një veprë penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;
- ii. për një veprë penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin Policisë së Burgjeve;
- iii. për një veprë penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e Policisë së Burgjeve;”.

Gjithashtu, në pikën 2, propozohet që të shtohet si kriter (shkronja d/1) fakti se për tu pranuar në Policinë e Burgjeve ndaj punonjësit nuk është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale ose nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje.

Në pikën 3 parashikohet shfuqizimi i kriterit që personi duhet të jetë nën moshën 35 vjeç.

Neni 3 parashikon që në nenin 42, pas pikës 2 të shtohet pika 2/1 ku përcaktohet se përjashtimisht, punonjësi i rolit bazë, pavarësisht gradës, mund të marrë gradën “nënkomisar” kur plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) zotëron një diplomë të ciklit të dytë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës, ose të zotërojë një diplomë të të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- b) është punonjës i rolit bazë për jo më pak se 2 vjet;

- c) ka përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës “nënkomisar”;
- ç) ka vlerësim vjetor pozitiv të punës për periudhën që ka qëndruar në gradën që mban;
- d) është shpallur fitues në procedurat konkurruese për ngritjen në gradë “nënkomisar”.”

Neni 4 parashikon ndryshime në nenin 51, të ligjit nr. 80/2020 ku përcaktohet se punonjësi i Policisë së Burgjeve pezullohet nga detyra kur:

- a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale; ose,
- b) merr cilësinë e të pandehurit për një krim të kryer me dashje.

Gjatë periudhës së pezullimit, punonjësi përfiton 50 % të pagës për gradë. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve shpallet i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë, rikthehet në punë dhe kompensohet për pjesën e mbetur të pagës, që duhej të përfitonte nëse nuk do të ishte pezulluar.

Neni 5 parashikon ndryshime në nenin 55 të ligjit nr. 80/2020 lidhur me rikthimin dhe përparësinë për praninë në strukturat e Policisë së Burgjeve. Rikthimi në Policinë e Burgjeve mund të bëhet në çdo kohë vetëm për nevoja të Policisë së Burgjeve dhe nëse personi është liruar nga Policia e Burgjeve me kërkesën e tij, për shkak të shkurtimit të funksionit ose për shkak të punësimit në struktura të tjera të administratës publike dhe plotëson kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës.

Kriteret për rikthimin në Policinë e Burgjeve vlerësohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila përgatit raportin përfundimtar mbi përshtatshmërinë ose jo të kandidatit.

Punonjësi kandidat rikthehet në Policinë e Burgjeve në gradën që ka pasur para lirimit. Në rast të mungesës së vendit vakant me gradën e mëparshme dhe me pëlqimin e tij, ai pranohet në pozicion pune me gradë më të ulët.

Kanë përparësi për praninë në Policinë e Burgjeve shtetasit që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura dhe që është liruar nga detyra me kërkesën e tij ose është liruar nga detyra për shkak të shkurtimit të funksionit dhe plotëson kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës.

Kriteret për përparësinë në praninë në Policinë e Burgjeve vlerësohen nga struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila përgatit raportin përfundimtar mbi përshtatshmërinë ose jo të kandidatit

Punonjësi kandidat pranohet në Policinë e Burgjeve në gradën që ka pasur para lirimit. Në rast të mungesës së vendit vakant me gradën e mëparshme dhe me pëlqimin e tij, ai pranohet në pozicion pune me gradë më të ulët.

Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm emërohen nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mbi bazën e propozimit të drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe punonjësit e rolit të lartë drejtues emërohen nga ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Drejtësisë, ministrit të Mbrojtjes dhe të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike, miraton ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës me Policinë e Burgjeve.

Neni 6, parashikon hyrjen e ligjit në fuqi.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektligji janë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Propozimi për ndryshimin e ligjit nr. 80/2020 është përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe është vlerësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit. Në përfundim të vlerësimit të propozimit, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit hartoi draftin e projektligjit.

Projektvendimi për propozimin e projektligjit do t'i përcillet nëpërmjet sistemit e-aktet Ministrisë për Financat dhe Ekonominë, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji nuk përcjell efekte financiare në buxhetin e shtetit pasi bën vetëm saktësime ligjore mbi kriteret e pranimit në Policinë e Burgjeve.

**MINISTRI**

**ULSI MANJA**